

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLU		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana. 08.12.2025		
Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 383	Nr. Faqeve. Br. Strana. 3
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga konsultimi publik ku u prezantua profili ekzistues mbi hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Me datën 02.12.2025 është mbajtur konsultimi publik me qytetarë dhe grupe të ndryshme të interesit ku është bërë prezantimi i profilit ekzistues mbi hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Në këtë takim ka marrë pjesë Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, Drejtori aktual i Urbanizimit Arbër Bytyqi, përfaqësues të Kompanisë INSI, Shyhrete Topalli, udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun, qytetarë dhe zyrtarë të tjerë.

Gjatë hapjes zyrtare të këtij konsultimi publik, Kryetari Aliu theksoi se ky proces është një ndër më të rëndësishmit për komunën.

“Sot nis një epokë e re, një kapitull i ri për Ferizajn, i cili duhet të ketë përmbajtjen dhe dimensionin e zhvillimit që tashmë ka marrë qyteti. Ferizaj është qyteti i tretë për nga numri i banorëve dhe i dyti për nga zhvillimi ekonomik. Por, Ferizaj tashmë ka edhe një epitete tjetër – epitetein e pushtuesit të lartësive, sukseseve dhe fitoreve; pushtuesit të modelit të transformimit dhe të mënyrës se si duhet të ecë përpara një qytet,” tha Aliu.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ai falënderoi qytetarët për kontributin e vazhdueshëm gjatë viteve, i cili ka ndikuar në transformimin urban të Ferizajt, duke theksuar se Plani Zhvillimor Komunal është dokument i rëndësishëm strategjik për të ardhmen e qytetit.

"Ky dokument duhet të ketë vizionin e duhur, në mënyrë që edhe kur unë të mos jem më kryetar, pasardhësi im të ketë rrugën e trasuar për të punuar për gjeneratat që vijnë," shtoi ai.

Për rëndësinë e procesit foli edhe drejtori i Urbanizimit, Arbër Bytyqi, i cili theksoi se PZHK është një ndër dokumentet më të rëndësishme strategjike të Komunës së Ferizajt.

Në këtë takim, përfaqësues të kompanisë INSI, e cila është kontraktuar për hartimin e PZHK-së, sqaruan se qëllimi i sesionit ishte informimi i qytetarëve për fazat e hartimit të planit, metodologjinë e punës, si dhe kornizën ligjore dhe institucionale që e rregullon këtë proces.

Pas këtij prezantimi fjalë ju dha qytetarëve të pranishëm në sallë të cilët paraqitën pyetjet dhe kërkesat e tyre në lidhje me këtë plan.

Nexhat Shahini – Përfaqësues i Ministrisë së Kulturës në Ferizaj

- PZHK është një dokument shumë i rëndësishëm, por kisha pasur një kërkesë që gjatë hartimit të këtij plani të respektohet Ligji i Trashëgimisë Kulturore, sepse në vazhdimësi po kemi probleme.

Kadri Kadriu – banor i lagjes "Sejdi Sejdiu"



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Qysh në vitin 2023 kemi bërë ankesë në Drejtorinë e Urbanizimit dhe deri më sot nuk kemi marrë ndonjë përgjigje në lidhje me këtë lagje. Si mund të ndodhë kjo ku gjysma e lagjes është ndërtim i lartë, e gjysma tjetër ndërtim i ulët? Ju lutem që këtë ta keni parasysh gjatë këtij procesi.

Imri Elezi – Shoqata e emergjencave 'Elita'

- A keni menduar që gjatë hartimit të këtij plani të bëni një strehimore për rastet emergjente për sigurinë e qytetarëve?

Burhan Haxha – Slivovë

- Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të bëni edhe një impiant të ujit në çdo shkollë dhe të ketë një qasje më të lehtë mauna në raste të zjarrit.

Betim Ahmeti – qytetar

- Sa do të jetë parametri i ndërtimit. Nëse ka mundësi të caktohen saktë këta parametra në mënyrë që të dihen saktë, sepse ka pasur kontradikta në kushtet e ndërtimit.

Pas fjalës së qytetarëve janë dhënë edhe komentet nga ana e drejtorit Arbër Bytyqi, dhe përfaqësuesit të INSI-t, Ismajl Baftiari.

Ky konsultim publik u mbyll në orën 11:40.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi